REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**

Nr.3365 Prot. Elbasan, më 10.06.2026

*Lënda:* **Njoftim për afishimin publik në faqen Web dhe këndin e njoftimeve publike.**

- **SEKTORIT I IT, BASHKIA ELBASAN**
- **NJËSIA ADMINISTRATIVE TREGAN**

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve",
- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- VKM nr. 625 datë 28.10.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan",
- Udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkive",
- Urdhëri nr 1003 datë 19.11.2025 Për ngritjen e grupeve të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjketeve të ndryshëm kërkues,për tu njohur si "posedues Jopronar"
- Kërkesës së paraqitur nga portali e-albania nga z. Drini Kyçyku.

Kërkojmë të bëhet afishimi publik me afat 45 (dyzet e pesë) ditor, bazuar në Ligjin Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", neni 10 pika 1 e cila ndër të tjera thotë *..., për pasuritë apo pjesët e tyre që përmbushin kushtet, bashkia kryen njoftimin me afishim publik për 45 (dyzet e pesë) ditë në ambientet e saj, në një vend tjetër publik brenda territorit të zonës, si dhe në faqen zyrtare të saj të internetit. Afishimi përmban listën e subjekteve me sipërfaqet respektive, përshkrimin e vendndodhjes së tyre dhe shoqërohet nga planet e rilevimit përkatëse*. Për sa më sipër kërkojmë që të merrni masat të bëhet afishimi pranë këndit të njoftimeve të njësisë Administrative Tregan, në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan si dhe në këndin e njoftimeve të Bashkisë Elbasan.

Planvendosja e pretenduesit të z.Drini Kyçyku ndodhet në njësinë administrative Tregan ndodhur ne zk.3633 , pasuria nr. 140/1/3 me një sipërfaqe prej 7400 $m^2$.*(Bashkangjitur plan vendosja)*Me përfundimin e afatit 45 ditor, duhet të përcillet procesverbali i mbajtur nga personi përgjegjës për afishimin, ku citohet përfundimi i afatit të afishimit, si dhe, nëse ka pasur ankesa apo jo lidhur me pasurinë në objekt trajtimi, në mënyrë që të vijojë me procedurën.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**K R Y E T A R I**
**Gledian Llatja**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel.00355 545 3416, E_mail:bashkiaelbasan@elbasani.gov.al*

# PLAN RILEVIMI E PRONES QE DO MERRET ME QERA

NR. I PASURISE.140/1/1-S2, ZK 3633 ADRESA E PASURISE: Bashkia ELBASAN ,TREGAN

POROSITI:_ " _DRINI SELIM KYÇYKU_"_

RELIEVI TOPOGRAFIK SH 1:750




ORTOFOTO SH 1:2500




POZICIONI NE HARTEN KADASTRALE SH 1:2500




Edison Mecaj

Digitally signed by Edison Mecaj
Date: 2026.03.10 15:35:02 +02'00'

Nr.140/1/3-S1, SIP. TOTALE = 7400M2

SISTEMI KOORDINATIV
UTM ZONA 34 N

Legjende:
- Kufi prone
- Objekte
- Mur
- Peme
- Porta
- Shtylle elektrike
- Kuota relative
- Rruge

RILEVOI :

EDIFAT shpk STUDIO Lic. N.4613/6
Ing.Ark. Edison Mecaj

SHKURT 2026